



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve**

Data: 04.04.2023

Nr: 47

Ora: 14:00

**VENDIM**

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 45, PARAQITUR NË KQZ NË DATËN  
02.04.2023**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 04.04.2023, me pjesëmarrjen e:

|                        |   |                |
|------------------------|---|----------------|
| <b>Elvin LAKO</b>      | - | <b>Relator</b> |
| <b>Elvis ÇEFA</b>      | - | <b>Anëtar</b>  |
| <b>Ilirjan RUSMALI</b> | - | <b>Anëtar</b>  |
| <b>Koli BELE</b>       | - | <b>Anëtar</b>  |
| <b>Ledio BRAHO</b>     | - | <b>Anëtar</b>  |

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Partia Aleanca Progresiste LZHK

**OBJEKT:** Kundërshtim i vendimit nr. 20, datë 30.03.2023, të KZAZ-së nr. 53,  
Bashkia Prrenjas

**BAZË LIGJORE:**

Nenet 21/c, 126, 129, 130 dhe 131 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve 17 dhe 18, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

**VËREN:**

Partia Aleanca Progresiste LZHK ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 45 regi., datë 02.04.2023.

Në mbledhjen e datës 04.04.2023, ora 14:00, pas relativitetit të z. Elvin Lako, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 45 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 129, pika 3, shkronja “a”, 130 dhe 131 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

**V E N D O S I:**

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 45, datë 02.04.2023 të paraqitur nga Partia Aleanca Progresiste LZHK.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 06.04.2023, ora 13:00.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

**Elvin LAKO** - **Relator**

**Elvis ÇEFA** - **Anëtar**

**Ilirjan RUSMALI** - **Anëtar**

**Koli BELE** - **Anëtar**

**Ledio BRAHO** - **Anëtar**